



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 147 Akti

Nr. 200 Vendimi
Tiranë, më 16.10.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Roland Ilia	Anëtar
Suela Zhegu	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në Tiranë, në datën 16 tetor 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Besim Hajdarmataj**, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili pranoi rezultatet e hetimit dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Besim Isa Hajdarmataj, aktualisht me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.5.2018, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, do të shqyrtohet nga trupi gjykues, i cili përbëhet nga komisionerët:

Alma Faskaj
Roland Ilia
Brunilda Bekteshi

Për arsye objektive, relatorja e çështjes, komisionere Alma Faskaj, me shortin e hedhur në datën 16.7.2018, u zëvendësua nga komisionere Suela Zhegu.

Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), në përputhje me nenet 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), në përputhje me nenet 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, në përputhje me nenin 43, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar².

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura

¹ Raporti i ILDKPKI -së dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 12.1.2018.

² Raporti i DSIK-së dërguar me shkresën nr. ***prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** prot., datë 18.12.2018.

sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores të çështjes në datën 1.4.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit paraprak, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Për një proces të rregullt ligjor z. Besim Hajdarmataj i janë garantuar të drejtat si: është njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin e hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova mbi rezultatet e hetimit paraprak brenda një afati 5 ditor.

Z. Besim Hajdarmataj ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij brenda afatit të caktuar në datën 5.4.2019.

Me përfundimin e hetimit administrativ, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit u depozituan tri denoncime. Trupi gjykues i mbledhur në datën 9.4.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, për të hetuar mbi këto denoncime.

Pas hetimit të këtyre denoncimeve, për një periudhë për më shumë se 5 muaj, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, ka vendosur të mbyllë hetimin dhe në datën 24.9.2019 vendosi t'i dërgojë subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit shtesë në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 4.10.2019 ka depozituar në Komision shpjegimet dhe provat brenda afatit të caktuar. Trupi gjykues, i mbledhur më 9.10.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi administroi dhe shqyrtoi provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti, vendosi të ftojë z. Besim Hajdarmataj në seancë dëgjimore në datën 14.10.2019, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 14.10.2019, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me

³ Raporti i PP-së dërguar me shkresën nr. ***, datë 3.7.2018.

përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI RIVLERËSIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, u krye bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: atë të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 12.1.2018, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/1 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; për verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e deklarimeve të rremë, apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016, nga ku rezulton se:

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, datë 28.1.2017, z. Besim Hajdarmataj ka deklaruar këto pasuri:

1. Depozita bankare: në shumën 5.000.000 lekë, në “NBG”;
në shumën 1.000.000 lekë, në “NBG”.
2. Llogari rrjedhëse e pagës me gjendje në shumën 995.704 lekë, në “BKT”.
3. Gjendje *cash* në shumën 500.000 lekë.

4. Dhurata nga vëllai me banim në Angli në shumat: 3.000 euro + 3.000 euro dhe 4.000 paund, të dërguara në vitet 2007, 2008 dhe 2009.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.8.2018, ka informuar se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve të tij nuk rezultojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme.

OSHEE-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 15.8.2018, ka informuar se subjekti nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me OSHEE-në.

UKT-ja, me shkresën nr. K-***, datë 13.8.2018, ka konfirmuar se për subjektin e rivlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata me UKT-në.

ALUIZNI, me shkresën nr. *** prot., datë 9.8.2018, ka sjellë përgjigje negative për aplikime në emër të subjektit.

DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.8.2018, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka në pronësi të tij ndonjë automjet të regjistruar.

Zyra e Gjendjes Civile Tiranë dhe ajo e **Tropojës** ka informuar statusin beqar të subjektit dhe përbërjen e tij familjare (i vetëm në certifikatën familjare).

Likuiditetet në bankë

1. Depozita bankare⁴: në shumën 5.000.000 lekë, në “NBG”;
në shumën 1.000.000 lekë, në “NBG”.

Për këto depozita bankare subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi kursimet nga pagat.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

“NBG”⁵ ka konfirmuar se subjekti ka një llogari depozitë në monedhën lekë, me gjendje në datën 6.8.2018, në shumën 6.073.921 lekë.

Gjatë hetimit administrativ subjekti ka shpjeguar se: ... nga viti 2016 e në vijim kursimet nga paga i ka mbajtur në llogarinë rrjedhëse të pagës, ndërsa kursimet e deklaruara në vite i ka depozituar në bankë në vitin 2017. Këto depozita bankare janë krijuar nga likuiditete *cash*, të mbajtura deri në vitin 2016 jashtë sistemit bankar, kohë kur subjekti i rivlerësimit i depozitoi këto likuiditeteve në “NBG”. Nga verifikimi i deklarimeve periodike ka rezultuar se subjekti ka i deklaruar rregullisht kursimet e tij.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me të dhënat e marra nga “NBG”.

2. Balancë kreditore në llogarinë rrjedhëse të pagës në “BKT” në datën 26.1.2017, sipas vërtetimit të datës 26.1.2017, në shumën 995.704,43 lekë. Subjekti ka deklaruar si burim krijimi: kursime nga paga, nga data 1.1.2016 deri më 31.12.2016.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Banka Kombëtare Tregtare⁶ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë rrjedhëse në shumën 995.704 lekë.

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmim balancë llogarie, lëshuar nga “NBG”-ja, gjendja e llogarisë në datën *** konfirmohet në shumat 5.000.000 lekë dhe 1.000.200 lekë; bashkëlidhur *statement* bankar datë ***.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.8.2018.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 16.8.2018.

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me të dhënat e marra nga “BKT”.

3. Gjendje cash në shumën 500.000 lekë

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi kursimet nga paga. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se nga të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe referuar analizës financiare, vërehet se ka pasur mundësi financiare për të akumuluar gjendjen e deklaruar *cash* në vlerën 500.000 lekë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tij.

Analiza financiare për likuiditetet e krijuara

Referuar ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë”, Komisioni kreu analizën financiare për të vërtetuar saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit deri në vitin 2016, si dhe mundësitë për të kursyer bazuar te të ardhurat e deklaruara dhe të dokumentuara, shpenzimet dhe likuiditetet gjatë kësaj periudhe.

Nga verifikimi i lëvizjeve bankare ka rezultuar se llogaria e subjektit është kredituar me një pagesë mujore si *bonus* transporti, për shkak të funksionit të drejtuesit.

Referuar dokumentacionit bankar të ardhurat e përfituara në llogarinë rrjedhëse, paraqiten si vijon:

- në vitin 2010, në shumën 420.000 lekë;
- në vitin 2011, në shumën 385.000 lekë;
- në vitin 2012, në shumën 420.000 lekë;
- në vitin 2013, në shumën 350.000 lekë.

“bonus transporti”, të ardhurat në total në shumën 1.575.000 lekë.

Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare, me arsyetimin se janë përdorur për transport nga subjekti.

Analiza e kryer nga Komisioni për periudhën 2003 – 2016 ka rezultuar në katër vite radhazi me një balancë negative, konkretisht: për vitin 2010, në shumën 19.173 lekë; për vitin 2011, në shumën 155.237 lekë; për vitin 2012, në shumën 348.563 lekë; dhe për vitin 2013, në shumën 457.916 lekë; në total në shumën 980.000 lekë.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime apo prova, për të provuar të kundërtën lidhur me balancën negative për vitet 2010 – 2013.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit

Subjekti ka shpjeguar faktin se nuk dispononte automjet në pronësi apo përdorim. Gjatë punës së tij në qytetin e Kurbinit dhe të Durrës, i është bashkuar në udhëtim kolegëve prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, të cilët udhëtonin nga Tirana për në Kurbin dhe anasjelltas, për periudhën janar 2010 deri në fund të muajit shkurt 2012 dhe nga Tirana – Durrës dhe anasjelltas nga muaji mars 2013 deri në fund të muajit dhjetor 2013. Për pasojë, këto shpenzime janë ndarë midis tyre.

Për këtë arsye, subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të Komisionit duhet të përfshihen shumat e kursyera nga të ardhurat e “bonusit të transportit”, pasi një pjesë e të ardhurave për transportin janë shpenzuar duke u ndarë me kolegët për transport.

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës edhe dy deklarata noteriale:

Lidhur me gjendjen cash të mbajtur jashtë sistemit bankar, si burim krijimi për këto depozita bankare Komisioni arsyeton se:

- Në deklaratat periodike janë deklaruar rregullisht, në mënyrë të detajuar dhe të dokumentuar, të ardhurat e subjektit, si dhe të gjitha likuiditetet dhe detyrimet, sipas pikës 5, të nenit 7, dhe nenit 21, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare, të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, të ndryshuar.

- Në deklaratën “Vetting” rezulton që subjekti, sipas pikës 13, të nenit 3 dhe formularit, shtojca 2, të deklaratës së pasurisë të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar saktësisht dhe në mënyrë të detajuar dhe të dokumentuar, të ardhurat nga paga dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme.

Nga verifikimet ka rezultuar se të dhënat e deklaruara në deklaratën “Vetting” përputhen me të dhënat e deklaruara zyrtarisht nga ILDKPKI-ja dhe institucionet bankare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se: *“Në plotësimin e deklaratave periodike kam pasur parasysh parashikimet ligjore të ligjit nr. 9094, datë 10.4.2003, të ndryshuar, si dhe formularët e deklaratimit të interesave private, nxjerrë nga ILDKPKI-ja. Ligji nr. 9094, datë 10.4.2003, ka pësuar ndryshime me ligjet nr. 85/2012 dhe me nr. 45/2014, ku në ligjin nr. 45/2014, pas nenit 4 është shtuar neni 4/1, ku parashikohet se të gjithë zyrtarët të cilët për shkak të funksionit publik që kryejnë, bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklaratimin për herë parë, sipas nenit 5/1 të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 milionë lekë.*

Megjithatë, nga viti 2016 e në vijim kursimet nga paga i kam në llogarinë rrjedhëse të pagës, ndërsa kursimet që kisha prej disa viteve i kam depozituar në bankë në vitin 2017 ku dhe i kam aktualisht, sipas deklaratimit të bërë në dokumentet e ‘Vetting’”.

Arsyetim ligjor dhe analiza e provave

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se në ushtrim të të drejtave që përcakton neni 47 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtën të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, konstaton se subjekti ka dhënë argumentet dhe opinionin e tij lidhur me këtë fakt të konstatuar nga Komisioni.

Përfundimisht, u morën në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, për faktin se këto kursime cash janë deklaruar rregullisht dhe saktësisht në deklaratimet periodike vjetore dhe, për sa më sipër, nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

4. Dhurata në shumën 3.000 euro, 3.000 euro dhe 4.000 paund nga vëllai i subjektit

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhura të përfituara si dhurata të një sasive monetare në vlerat 3.000 euro, 3.000 euro dhe 4.000 paund nga i vëllai me banim në Angli gjatë viteve 2007, 2008, 2009, duke deklaruar si burim krijimi: të ardhura të përfituara nga puna e të vëllait, bashkëlidhur dokumentacion të lëshuar nga autoritetet angleze dhe deklaratë personale nga vëllai A. H.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Komisioni, bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit shpjegime dhe dokumentacion për të justifikuar ligjshmërinë dhe burimin të krijimit për dhuratat e përfituara nga personi tjetër i lidhur, vëllai i subjektit, me banim në Angli.

Subjekti ka depozituar në formën e kërkuar ligjore dokumentacionin ligjor provues për të ardhurat e ligjshme të vëllait të tij, me vërtetim përkthimi nga noterja F. M, si më poshtë vijon:

- Vërtetim lëshuar në datën 6 nëntor 2018 nga punëdhënësi (kompania “AKS”) i të vëllait për vitet maj 2005 – janar 2007, me anë të së cilës vërtetohet marrëdhënia e punësimit e z. A. H.
- *Statement*-e bankare nga “B.BANK”, në emër të shtetasve A. H dhe A.V.J, ku evidentohen pagesa punësimi apo kreditime të kryera rregullisht të kësaj llogarie nga punëdhënësit, për periudhën 2006 – 2009.

Vëllai i subjektit ka qenë punonjës i siguruar në shoqërinë “G” LTD dhe për pagesat e marra pranë këtij punëdhënësi është paguar tatim sipas përshkrimit në dokumentet e lëshuara nga shoqëria “G” LTD për vitet 2006, 2008, 2009. Fotokopje të pasaportës së vëllait, ku provohet të ketë pasur hyrje - dalje përgjatë këtyre viteve.

Arsyetim ligjor dhe analiza e provave

Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me vërtetësinë e deklarimeve, ka rezultuar se subjekti i ka deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2007, 2008, 2009 se këto dhurata janë dhënë nga vëllai i tij. Nga hetimi i kryer u konstatua se nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezultoi se vëllai i subjektit ka hyrje-dalje që prej vitit 2006 e në vijim, referuar dhe fotokopjes së pasaportës të vënë në dispozicion nga subjekti për periudhën 2006 – 2009. Trupi gjykues arrin në përfundimin se dokumentacioni ligjor i paraqitur nga subjekti është i plotë dhe në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe në bazë të këtij dokumentacioni, të ardhurat e ligjshme të vëllait për të cilat janë paguar detyrimet tatimore paraqiten si më poshtë:

Të ardhura sipas viteve të dokumentuara	2006	2007	2008	2009	Total GBP
	3 555	3378	11 758	7 414	26 106
Dhurata për subjektin		3 000 euro	4 000 GBP	3 000 euro	

Lidhur me ligjshmërinë e tyre, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar sa më sipër, vlerëson dhe provon se të ardhurat për periudhën 2006 – 2009 janë në vlerën 26.106 paund, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, për justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të masës së të ardhurave të dhuruara nga vëllai i tij, në raport edhe me shpenzimet jetike.

Lidhur me banesat në përdorim

Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka deklaruar se:

Nga viti 2003 – 2007 ka banuar në një shtëpi me qira në lagjen “P”, B. Curri, në pronësi të z. A. K, në vlerën 7.000 lekë (shumë e përfshirë në analizën financiare).

*Nga shtatori 2007 – maj 2009, subjekti ka banuar në adresën: “Rruga e Kavajës”/B. R, pallati “O. *”, kati ** i banimit, apartamenti **, Tiranë, me pronar shtetasin P. P, me kosto qiraje 15.000 lekë/muaj.*

*Nga maji 2009 e në vijim, banon në shtëpinë e blerë nga vëllezërit, me adresë: Rr. “A.M”, pallati “M”, nr. *, shkalla “*”, apartamenti **, Tiranë.*

Lidhur me vërtetësinë e deklarimeve të subjektit, nga verifikimi i tyre me deklaratat periodike vjetore, u konstatua se deklaratat e subjektit përputhen me adresat e deklaruara në deklaratat periodike, të cilat paraqiten si më poshtë:

Viti	Adresa të deklaruara në Deklarimet Periodike Vjetore
2004	Njësia Administrative Bajram Curri, lagjja “** G”, B. Curri
2005	Lagjja “P”, ⁷ Bajram Curri, Tropojë
2006	Lagjja “P”, Bajram Curri, Tropojë
2007	Lagjja “P” Bashkia B. Curri
2008	Lagjja “P”, Qyteti Bajram Curri, Tropojë Bashkia * (Gj. Civile) Lagjja ish-parku, Rr. “B. R”, shk. *, k. *, ap. *, Tiranë
2009	Lagjja “P”, Bashkia Bajram Curri, Tropojë Lagjja ish-parku, Rr. “B. R”, shk. *, k. *, ap. *, Tiranë
2010 – 2016	Adresa e gjendjes civile: “Njësia Administrative Nr. *, Tiranë”

Në përgjigjet e pyetësorit standard, të ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2018, subjekti ka deklaruar lidhur me banimin aktual se: *“Nga viti 2011 – 2017 si dhe aktualisht banoj në një apartament me nënën, vëllain dhe familjarë të tij, në adresën e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit: Adresa: Rruga ‘A.M’, P. ‘M’, nr. **, Shk. ‘***’, apartamenti **, qyteti Tiranë, apartament i vëllezërve. Ndërsa jam i regjistruar në zyrën e gjendjes civile ‘Njësia Administrative Nr. *, Tiranë’”.*

Në lidhje me pagesën për blerjen e apartamentit, në përgjigjet e pyetësorit të datës 21.12.2018, subjekti ka deklaruar: *“Vëllai im, G, pagesën e ka bërë tek firma ndërtuese, pikërisht në kohën e nënshkrimit të kontratës. Për këtë fakt, në atë kohë nuk është përpiluar ndonjë akt tjetër për pagesën, pasi mënyra e pagesës është parashikuar dhe në kontratë, por vëllai mbi bazën e kërkesës time, ka marrë një vërtetim nga firma ndërtuese për pagesën e bërë”.*

Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit vërtetimin nr. ***, datë 14.12.2018, lëshuar nga shoqëria “M-***” sh.p.k., në të cilën parashtrohet se z. G. H është klient i shoqërisë dhe ka porositur një apartament banimi sipas kontratës nr. ***, datë 12.3.2007, në vlerën 52.580 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht me nënshkrimin e kontratës.

Komisioni, me shkresën nr. ** prot., datë 28.12.2018, ka kërkuar informacion pranë shoqërisë së ndërtimit “M” sh.p.k., e cila në përgjigjen e saj ka shpjeguar se me shtetasin G.H ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje me nr. ***, datë 12.09.2007, për një apartament dhe pagesa është likuiduar totalisht. Për këtë arsye ka qenë e panevojshme prerja e mandateve, sepse përshkrimi në kontratë është i përcaktuar shumë qartë dhe i plotë.

Për të verifikuar vërtetësinë e deklarimeve të subjektit, Komisioni ka kërkuar dokumentacion pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit (ku është subjekt deklarues), e cila me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2019, ka depozituar kopje të deklaratës së pasurisë të vitit 2018 të z. G. H.

Sipas deklaratës së pasurisë, z. G. H ka deklaruar për këtë pasuri: *Apartament banimi me sip. 111.87 m², ndodhur në Rr. “A. M”, blerë më 12.9.2007, sipas kontratës së porosisë nr***, datë 12.9.2007, në vlerën 52.580 euro.* Burimi i krijimit të kësaj pasurie: kursime nga të ardhurat familjare për vitet 1996 – 2007, në vlerën 1.500.000 lekë; huamarrje pa interes marrë një personi fizik në shumën 10.000 euro, pa interes, të likuiduara; të ardhura nga vëllai, z. A. H, si emigrant në Angli, në shumën 30.000 euro.

⁷ Në përgjigje të pyetësorit të datës 24.10.2018, subjekti ka deklaruar se nga viti 2003 – 2007 ka banuar në një shtëpi me qira në lagjen “P”, B. Curri, në pronësi të z. A. K.

Për sa më sipër, nga hetimi i kryer deklarimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me deklaratën e pasurisë së vëllait të tij, z. G. H. Pasuria e vëllezërve të subjektit është blerë dhe likuiduar në vitin 2007 kur subjekti ka banuar në një banesë tjetër me qira. Komisioni nuk ngriti dyshime për të, pasi vëllai i tij është subjekt deklarimi dhe kjo është e vetmja pasuri banesë e blerë prej tyre, për pasojë nuk ka konstatuar ndonjë rrethanë dyshuese për këtë pasuri.

Arsyetimi i Komisionit në lidhje me këtë apartament

Komisioni në analizë të fakteve sa më sipër ka konstatuar se, sipas aktit noterial pasuria apartament është blerë e likuiduar në vitin 2007, ku subjekti nuk është as kontribues e as përdorues i kësaj pasurie, pasi dhe sipas deklarimit periodik vjetor deri në 2009 ka banuar në një banesë tjetër me qira, për faktin se kjo pasuri është deklaruar si pasuri e blerë nga vëllezërit, faktin se personat e tjerë të lidhur nuk disponojnë banesë tjetër në pronësi, faktin që subjekti sipas certifikatës familjare të administruar paraqitet i vetëm, si dhe për faktin që deklarimet e subjektit të rivlerësimit, përputhen me deklaratën e pasurisë së vëllait si subjekt deklarues, trupi gjykues nuk ka konstatuar ndonjë rrethanë dyshuese për këtë pasuri.

Elementi i vetëm i cili e lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë apartament në pronësi të vëllezërve të tij është fakti i deklaruar prej subjektit se ai banon në një dhomë në apartamentin e vëllezërve të tij, ku gjithashtu banojnë vëllai dhe familja e tij, nëna e subjektit dhe motra.

Trupi gjykues, në rrethanat kur nuk rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit, të dhëna apo dyshime që kjo pasuri është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, situatë e cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, çmon se detyrimi që subjekti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtij apartamenti është një detyrim në tejkallim të parashikimeve ligjore.

Bazuar në parimin e proporcionalitetit, trupi gjykues vlerëson se shtrirja e hetimit edhe te pronat e familjarëve të tjerë (vëllezërve të subjektit dhe në përdorim të prindërve të subjektit), nuk mund ta ngarkojë subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë si subjekt deklarues, pasi kjo del jashtë qëllimit të ligjit.

Nga hetimi i kryer nuk rezultoi asnjë situatë e dyshuar e rrethana objektive se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, pra, trupi gjykues vlerëson se subjekti provoi ligjshmërinë e burimit të krijimit për personin tjetër të lidhur, për shumat e dhuruara në vlera monetare dhe se pasuria e personave të tjerë të lidhur nuk ishte objekt verifikimi i këtij trupi gjykues, në përputhje me sa parashikon neni 32/4, i ligjit nr. 84/2016.

Komisioni, duke marrë *indicie* nga denoncimet anonime nr. *** prot., datë 5.4.2019; nr. *** prot., datë 8.4.2019; dhe një denoncim anonim në adresë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, i cili u përcoll në Komision në datën 9.4.2019, ka kryer hetim shtesë për kriterin e pasurisë, duke kërkuar informacion nga institucionet publike dhe private. Në këto denoncime ngriheshin pretendime për pasuri të paluajtshme të subjektit, të regjistruar në emër të personave të tjerë, por këto pretendime nuk ishin të mbështetura në ndonjë provë konkrete.

Referuar këtyre denoncimeve, Komisioni kreu një hetim të thellë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e përmendur në këto denoncime, duke i kërkuar informacion ILDKPKI-së, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe OSHEE-së, për të verifikuar pasuri të regjistruara në emër të këtyre personave.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i ardhur nga këto institucione publike, si dhe nga deklarimet e dëshmitares O. Ll., e cila e kishte njohje me subjektin, u konfirmuan të njëjtat

pasuri që Komisionit i kanë rezultuar nga hetimi administrativ, duke mos u provuar pretendimet për pasuri të fshehura, sipas denoncimeve anonime.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ardhur nga institucionet shtetërore, por edhe nga shoqëritë private, nuk u konfirmuan pretendimet e denoncuesve, si dhe nuk rezultuan të dhëna të dyshimta që mund të lidheshin me subjektin e rivlerësimit.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të pasurisë

Nga hetimi i thellë administrativ për vlerësimin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elementë, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme dhe pas verifikimit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

B. KONTROLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016

DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, *ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të z. Besim Hajdarmataj.*

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Komisioni ka kryer një hetim të thellë për subjektin e rivlerësimit, duke marrë shkas nga *indiciet* e denoncimeve anonime, referuar sa më sipër dhe ka kërkuar informacion nga institucionet ligjzbatuese për të verifikuar çdo pretendim të parashtruar në to, si dhe nëse subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përmendur në denoncimet apo dhe persona të tjerë. Trupi gjykues, për verifikimin e këtyre fakteve, ka çmuar të thërrasë në cilësinë e dëshmitarit shtetasit M. L., O. Ll., E. B., dhe S. S.

Në kuadër të verifikimit të pretendimeve të parashtruara në denoncim, Komisioni ka kryer hetim dhe ka kërkuar informacion për subjektin dhe personat e cituar në denoncim në institucionet: DSIK, Prokurorinë e Krimeve të Rënda, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorinë e Përgjithshme, ILDKPKI, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Prokurorinë e Rrethit Kurbin, Prokurorinë e Rrethit Pogradec, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Tirana International Airport, Lufthansa Albania, etj.

Pas një hetimi të thelluar për pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, nga institucionet ligjzbatuese nuk u konfirmua asnjë pretendim i parashtruar në denoncimet që të përbënte shkak për cenimin e figurës së subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Raporti i hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme është mbështetur në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Detyrat e kryera nga subjekti 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Referuar raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit:

- shkurt 2013 – maj 2015, ka ushtruar funksionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- nga maj 2015 – mars 2016, ka ushtruar detyrën e zëvendësdrejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë;
- pas marsit të vitit 2016, ka ushtruar funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, deri në maj të vitit 2018.

Gjatë periudhës mars 2016 dhe deri në datën e dorëzimit të këtij formulari, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili përveç drejtimit organizativ dhe administrativ, ka marrë përgjegjësitë dhe ka ushtruar kontroll duke miratuar zgjidhjet e bëra për secilin nga procedimet penale.

Përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit, subjekti, me cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ka vendosur shfuqizimin e akteve të prokurorëve, vendime pushimi, dërgime për gjykim, pezullim të hetimeve, mosfillim të procedimeve penale, të cilat pasqyrohen në raportin e analizave vjetore të prokurorisë.

Për sa u përket të dhënave statistikore, prokurori Besim Hajdarmataj ka deklaruar se në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë ka regjistruar dhe ka kryer hetime për 40 (dyzetë) procedime penale, ku për shkak të ngarkesës në punë, me funksionin e drejtuesit, gjatë hetimit, procedimet penale u janë caktuar për kryerjen e hetimeve prokurorëve të tjerë. Subjekti deklaroi se në tri vitet e fundit të detyrës ka përfunduar pesë procedime penale, ndërkohë që ka mbartur në hetim tri procedime penale.

TË DHËNAT ARKIVORE

Nga të dhënat arkivore, referuar nga Prokuroria e Përgjithshme, për subjektin e rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj:

- nuk rezultojn të ketë pasur masa disiplinore lidhur me punën e kryer;
- të ketë të dhëna apo *indicie* nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).
- të ketë pasur ndaj tij procedime penale të pushuara apo të pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- të ketë pasur ndaj tij procedim penal të mosfilluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.2.2018.

Në vlerësimet e punës të subjektit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm “shumë mirë” për aftësitë profesionale.

Prokuroria e Përgjithshme në raportin e dërguar është bazuar në formularin e vetëdeklarimit, në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, si dhe në pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

Nga verifikimi i dosjeve nga Grupi i Punës, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, prokurori Besim Hajdarmataj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore dhe e vendos atë në realitet, duke e ndërthurur interpretimin me provat e administruara.

Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale, për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore. I kushton rëndësi analizës së provave të administruara.

Subjekti ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet e hartuar prej tij janë në respektim të dispozitave procedurale penale dhe të akteve nënligjore.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Besim Hajdarmataj, është eficient dhe efektiv. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë, duke pasur parasysh edhe specifikën e çështjeve të ndjekura nga prokuroria e krimeve të rënda, të cilat paraqesin kompleksitet apo detyrën e tij si drejtues dhe zëvendësdrejtues. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka marrë në shqyrtim denoncimet e

ardhura për subjektin e rivlerësimit, ndaj të cilit rezultojnë 17 të tilla, të depozituar pranë Komisionit dhe nga verifikimi i tyre nuk u konstatuan fakte apo rrethana që mund të përbëjnë provë në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional të subjektit.

Denoncime të tjera

Pas mbylljes së rezultateve të hetimit, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe në Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit u depozituan tri denoncime anonime.

Trupi gjykues, i mbledhur në datën 9.4.2019, pasi u njoh me përmbajtjen e tyre, evidentoi faktin që këto denoncime nuk plotësonin kërkesat e nenit 53.2 të ligjit nr. 84/2016, por duke vlerësuar përmbajtjen e këtyre denoncimeve, vendosi të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, për kryerjen e verifikimeve shtesë.

Komisioni vendosi të kryejë një hetim të thellë administrativ, duke hetuar mbi çdo pretendim të ngritur në këto denoncime dhe duke kërkuar informacion dhe dokumentacion pranë institucioneve publike dhe private.

Në lidhje me këto procedimet penale, Komisioni ka kërkuar pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda dosjet penale ku subjekti paraqitet në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, që i përkasin:

- i) procedimit penal nr. ***/2013, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për të cilin është shpallur moskompetenca dhe aktet janë dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- ii) procedimit penal nr. ***/2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet;
- iii) procedimit penal nr. ***/2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Gjithashtu, u kërkuar dosjet penale të:

- i) Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, dosja e procedimit penal ndaj gjyqtarës T. H., pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për “shpërdorim detyre”, e transferuar nga Durrësi në Elbasan;
- ii) Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, dosja lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2010, në ngarkim të shtetasit M. L.

Pas verifikimit të pesë procedimeve penale, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

- Procedim penal nr. ***/2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për të cilin është shpallur moskompetencë dhe aktet janë dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ku subjekti i rivlerësimit është në funksionin e drejtuesit të prokurorisë.

Në datën 12.5.2017, dy vjet pas regjistrimit të procedimit penal, janë regjistruar emrat e personave nën hetim B. P., Gj. Ç., dhe P. Rr., si persona të dyshuar, duke caktuar masat e sigurimit “arrest në burg”, për kryerje të veprës penale “trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 238/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Nga analizimi i akteve në dosjen penale është konstatuar se:

1. Nga prokurori i çështjes nuk është kryer asnjë lloj hetimi lidhur me nivelet më të larta të organizatës kriminale/drejtuesit e aktivitetit kriminal.

2. Me një vonesë të pajustificueshme (1 vit pa kryer asnjë hetim), subjekti i rivlerësimit, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës për Krimet e Rënda, ka vendosur në datën 8.5.2017 të zëvendësoje prokurorin e çështjes B.D, me qëllim që të kryheshin hetimet në lidhje me çështjen penale nr. ***/2013
3. Cilësimi juridik që është propozuar nga prokurori i krimeve të rënda, në fund të hetimit duket i gabuar.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është shprehur se: lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje, që është moskompetenca dhe kalimi i akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda ka qenë dakord me zgjidhjen e dhënë nga prokurorët e çështjes. Firmosja e shkresës përcjellëse është shprehje miratimi dhe ende nuk kishin hyrë në fuqi parashikimet e reja ligjore të Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrat e tij mbikëqyrëse të stafit, duke toleruar mosveprimin fillestar (që zgjati dy vjet), duke miratuar pas dy vitesh një kërkesë për caktimin e masës “arrest në burg” dhe duke miratuar transferimin e procedimit penal në Prokurorinë e Rrethit Shkodrës.

Në prapësimet e datës 4.10.2019 të subjektit, në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se është komanduar në funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datën 15.3.2016 dhe më pas është emëruar në këtë funksion.

Subjekti ka argumentuar se gjetjet e Komisionit në lidhje me shtetasin B.P janë shumë të sakta, kur i referohen rastit të arrestimit të shtetasve Gj.C dhe P.Rr, ndërkohë që nuk ishte e qartë arsyeja e mosprocedimit të shtetasit me B. P. bashkë me këta persona.

Subjekti ka argumentuar se gjetjet e Komisionit nuk kanë pse të konsiderohen si shkelje nga subjekti, si dhe nuk duhet ta ngarkojnë me përgjegjësi, pasi:

- Së pari, me cilësinë e drejtuesit, nuk kishte mundësi të evidentonte në një periudhë të shpejtë secilin nga procedimet penale të cilat kishin problematika në zvarritjen e hetimeve. Pasi ka marrë informacion të plotë nga Oficeri i Policisë Gjyqësore dhe prokurori për ecurinë e hetimeve dhe nuk ka gjetur një reagim nga prokurori për vënien në lëvizje të veprimeve, ka vendosur zëvendësimin e tij nga hetimi i mëtejshëm i çështjes. Zëvendësimi i prokurorit ka ardhur pikërisht pas këtyre konstatimeve.

- Së dyti, për sa i përket qëndrimit kontradiktor të miratimit të shkresave për kërkesat për caktimin e masës së sigurimit dhe të nënshkrimit të shkresës për transferimin e procedimit penal, që nënkupton miratimin e kërkesave dhe vendimit të prokurorëve, roli i Drejtuesit të Prokurorisë ka qenë në respektim të plotë të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes.

Subjekti ka argumentuar se me miratimin e ligjeve paketë të reformës në drejtësi është miratuar nga ligjvënësi ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Ndryshe nga ligji organik i mëparshëm, tashmë ligji i ri ka decentralizuar funksionimin e prokurorisë nga shkalla hierarkike, duke kufizuar plotësisht kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale për çështje të veçanta. Në nenin 43 të ligjit përcaktohen kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë në *ushtrimin e ndjekjes penale, ku në pikën 1, germa “b”, parashikohet se Drejtuesi i Prokurorisë: b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji; ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme*

procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake; dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në nenet 47 dhe 48 të këtij ligji, parashikohen rastet kur prokurori më i lartë mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme të detyrueshme, të cilat kanë të bëjnë me organizimin e punës, si dhe udhëzime jo të detyrueshme për çështje penale konkrete. Në këtë kuptim, udhëzime jo të detyrueshme kanë të bëjnë me fazën e hetimeve derisa prokurori nuk ka marrë një vendim përkatës. Me marrjen e vendimit prokurori më i lartë nuk mund të cenojë jo vetëm vendimmarrjen, por as të nxjerrë udhëzime të tilla, pasi do të cenohej autonomia dhe pavarësia e prokurorit, si një risi e re me ligjin e ri.

Në zbatim të këtij ligji ka dalë edhe udhëzimi nr. 2, datë 29.12.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori”, ku në pikën 2, ndër të tjera, parashikohet: “Vendimet dhe kërkesat arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes”. Në pikën 3, parashikohet: “Drejtuasi i Prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm nënshkruan shkresat përcjellëse të akteve/shkresave të prokurorit në gjykatë, tek subjektet e tjerë të procedimit penal ose subjekte të tjerë”.

Në lidhje me udhëzimet e detyrueshme për çështje konkrete, parashikohet se Drejtuesi i Prokurorisë ka ta drejtë të verifikojë ecurinë dhe përfundimin e çështjes dhe, kur e vlerëson të nevojshme, të udhëzojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, përpara se të merret vendimi për mënyrën e përfundimit të çështjes. Këto udhëzime nuk janë të detyrueshme për prokurorin e çështjes.

Mbi bazën e decentralizimit të prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, me ndryshimet e pësura në ligjin nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimi nr. 2, datë 29.12.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm, me cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, subjekti ka argumentuar se ka zbatuar pavarësinë dhe autonominë e prokurorëve në zgjidhjet konkrete, ndërkohë që nuk ishte rasti kur prokurori më i lartë mund të ndërhyjë me asnjë udhëzim, ndërkohë që është marrë një vendimmarrje.

Në këtë çështje konstatimet e Komisionit i referohen veprimeve të subjektit të rivlerësimit në rolin e drejtuesit të prokurorisë.

Trupi gjykues ka konkluduar se:

Subjekti i rivlerësimit, si drejtues i prokurorisë, është nënshkrues i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes se moskompetencës marrë nga prokurori i çështjes, duke vepruar në respektim të ndryshimeve ligjore të miratuara, konkretisht të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, të dalë në zbatim të tij, në respektim të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes, trupi gjykues ka çmuar se nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në funksionin e drejtuesit.

- Procedimi penal nr. ***/2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, ku janë zhvilluar hetime në procedimin penal nr. ***/2017, subjekti i rivlerësimit është në detyrën e drejtuesit të prokurorisë.

Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se në qytetin e Përmetit, në datën 8.4.2017, policia e shtetit ka gjetur dhe sekuestruar në një magazinë, pronë shtetërore, një sasi lënde narkotike *Cannabis*

Sativa, me peshë totale 11.650 kg. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se personat e përfshirë në aktivitetin e posedimit të lëndës ishin shtetasit K. Z, E.A, I.S dhe R.M.

Prokurori i çështjes ka vendosur më 27.7.2017 të shpallë mungesë kompetence lëndore dhe të transferojë procedimit penal nr. ***/2017 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.

Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, ka qenë dakord me zgjidhjen e dhënë nga prokurori për transferimin e kësaj çështjeje, që është moskompetenca dhe kalimi i akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.

KLP-ja, në raportin e hartuar për këtë rast ka konstatuar se nga shqyrtimi i akteve të fashikullit penal nr. ***/2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, konstatohet se përfshirja e subjektit të rivlerësimit në hetimin e këtij procedimi penal është në rolin e drejtuesit të institucionit, konkretisht në administrimin e funksionimit të brendshëm të institucionit në lidhje me shpërndarjen e dosjeve dhe miratimin e shkresave përcjellëse të përpiluara nga prokurorët.

Lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje, që është moskompetenca dhe kalimi i akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, ka qenë dakord me zgjidhjen e dhënë nga prokurori i çështjes. Firmosja e shkresës përcjellëse është shprehje miratimi nga Drejtuesi i Prokurorisë. Nuk kishin hyrë në fuqi parashikimet e reja ligjore të Kodit të Procedurës Penale.

Nga shqyrtimi i akteve nga Komisioni, vërehet se hetimi dhe vlerësimi i veprave penale të regjistruara në Prokurorinë e Krimeve të Rënda është përqendruar në të pandehurit që janë kapur në vendin e ngjarjes dhe nuk është kryer asnjë hetim në mënyrë që të evidentohet se kush ishin organizatorët e këtij aktiviteti. Mbledhja dhe paketimi i 11,650 kg kanabis me vlerë të konsiderueshme, e cila kishte qenë në atë ambient për një periudhë të konsiderueshme kohe para se të kapej, ishte e dukshme që ishte për qëllim trafikimin ndërkombëtar të drogës dhe kërkonte një lloj organizimi ku të përfshinte një numër të madh personash. Prokuroria për Krimet e Rënda nuk kishte kryer një hetim proaktiv për të identifikuar anëtarët e drejtues të grupit të strukturuar kriminal, të cilët po drejtonin një operacion shumë të madh të trafikut të lëndës narkotike.

Duke vepruar kështu, Prokuroria për Krimet e Rënda ka injoruar provat e shumta të gjetura për të ngarkuar me përgjegjësi penale individë të përfshirë në këtë aktivitet si bashkëpunëtorë (neni 26 i Kodit Penal) ndaj një grupi të strukturuar kriminal (neni 28.4 Kodi Penal) i angazhuar në “prodhimin dhe shitjen e narkotikëve” (neni 283 Kodi Penal), të cilat janë krime nën kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda. Nga shqyrtimi i akteve u evidentuan një sërë veprimesh hetimore të cilat duhet të ishin kryer.

Rezulton se nga Prokuroria e Krimeve të Rënda nuk është kryer një hetim proaktiv dhe shterues, duke marrë në vlerësim të gjitha provat dhe faktet e përfshira në këtë çështje.

Në prapësimet e datës 4.10.2019, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se gjetjet e Komisionit në lidhje me veprimet e tij i referohen nënshkrimit të shkresës përcjellëse për transferimin e procedimit, si shprehje miratimi e vendimit të prokurorit të çështjes, ndërkohë që nuk kishin hyrë në fuqi parashikimet e reja ligjore të Kodit të Procedurës Penale.

Ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale ishin miratuar dhe hyrja në fuqi ishte çështje ditësh, por kohë më parë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 97/2016, datë 23.11.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 97/2016, si dhe bazuar në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, kompetencat e prokurorit më të lartë në ushtrimin e ndjekjes penale për çështje konkrete gjenin vend vetëm për sa i përket fazës së hetimeve, ndërkohë që akoma nuk është marrë një vendim nga prokurori i çështjes. Edhe në fazën e hetimeve, udhëzimi i prokurorit më të lartë nuk është i detyrueshëm, ku edhe në këtë rast prokurori i çështjes gëzon autonomi të plotë në orientimin e hetimeve.

Duhet theksuar fakti se në rastin e transferimit të procedimeve prokurorive të tjera, ekziston një mënyrë kontrolli se nëse prokuroria që merr aktet nuk është dakord me vendimin e shpalljes së moskompetencës, njofton Prokurorinë e Përgjithshëm. Ky veprim nuk është kryer nga prokuroria pritëse, që nënkupton se ka qenë dakord me shpalljen e moskompetencës.

Në këtë çështje, konstatimet e Komisionit i referohen veprimeve të subjektit të rivlerësimit në rolin e drejtuesit të prokurorisë.

Trupi gjykues ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, si drejtues i prokurorisë, është nënshkruar i shkresës përcjellëse të vendimit të shpalljes së moskompetencës datë 27.7.2017, marrë nga prokurori i çështjes, duke vepruar në respektim të ndryshimeve ligjore të miratuara, konkretisht të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe udhëzimit nr. 2, datë 29.12.2016, “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, të dalë në zbatim të tij, në respektim të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorëve të çështjes.

Trupi gjykues çmon se në çfarëdolloj rrethane të ngritjes së dyshimeve, apo fakteve të moskryerjes së hetimeve për këtë rast, duhet të konsiderohen në vlerësimin e subjektit tjetër të rivlerësimit, prokurorit të çështjes, si përgjegjësi e tij për hetime të plota dhe shteruese.

Në konsideratë të faktit se në vlerësimin drejt të situatës konkrete, ku roli i subjektit si drejtues nuk mund të ngarkohet apriori me elemente dyshimi të qëllimshme, trupi gjykues vlerëson se qëllimi duhet të provohet dhe jo të ngrihet mbi bazë hamendësimi.

- Lidhur me procedimin penal nr. ***/2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ku janë zhvilluar hetime në procedimin penal nr. ***/2016, subjekti i rivlerësimit z. Besim Hajdarmataj, është në funksionin e drejtuesit të prokurorisë.

Referuar dosjes penale, nga hetimet e kryera ka rezultuar se i pandehuri Q. X., siguronte lëndë narkotike *Cannabis Sativa*, të papërpunuar, në fshatrat e Krujës. Në banesën e tij është sekuestruar një sasi prej 668 kg e 337 gr., *Cannabis Sativa* dhe janë arrestuar në flagrancë personat e dyshuar.

Sipas udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, materiali i është caktuar për veprime të mëtejshme prokurorit G. T., i cili në datën 25.9.2015 ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprën penale të dyshuar “trafikim i lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Në datën 31.5.2016 është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe kalimi i akteve të procedimit penal nr. ***/2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si prokuroria që ka kompetencën lëndore dhe tokësore.

Akti është përpiluar nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, z. Besim Hajdarmataj.

Nga verifikimi i procedimit penal ka rezultuar se:

- Subjekti i rivlerësimit, prokurori Besim Hajdarmataj, është komanduar Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në datën 15.3.2016 dhe më pas është emëruar Drejtues i Prokurorisë. Përfshirja në hetimin e procedimit nr. ***/2015 lidhet me nënshkrimin e shkresave përcjellëse në kuadër të hetimit, miratimi i zgjatjes së afatit të hetimeve të datës 15.4.2016. Drejtuesi i Prokurorisë ka dhënë zgjidhjen përfundimtare në hetimin e këtij procedimi duke vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në datën 31.5.2016.

- Nga aktet e administruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës konstatohet se nuk ka vendim zëvendësimi dhe se veprimet hetimore janë ndjekur nga prokurori G. T.

- Ndërsa vendimi i shpalljes së moskompetencës në datën 31.5.2016 është përpiluar nga Drejtuesi i Prokurorisë, z. Besim Hajdarmataj. Në këtë fashikull nuk rezulton të ketë akt që argumenton arsyen se përse vendimi i moskompetencës është përpiluar nga drejtuesi i prokurorisë.

Komisioni konstatoi se nga shqyrtimi i akteve të dosjes duket se hetimet e kryera janë fokusuar vetëm te personat e kapur në flagrancë në vendngjarje. Nuk rezulton që të jenë kryer veprime të mëtejshme hetimore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, për të verifikuar nëse ka pasur persona të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet. Nga hetimi i kryer nga prokuroria nuk u arrit të zbardhej dhe të konkludohej se cili ishte destinacioni i sasisë së lëndës narkotike të gjetur që do të trafikohesh.

Subjekti, në prapësimet e datës 4.10.2019, ka argumentuar se përfshirja e tij si drejtues i prokurorisë në këtë çështje ka ardhur si rezultat i konstatimit të disa problematikave, si më poshtë vijon:

- Së pari, rezulton se ishin bërë hetime për një periudhë mbi shtatë muaj dhe ishin zgjatur afatet e hetimeve me dy vendime zgjatjeje, njëra me tre muaj, dhe tjetra me dy muaj, dhe megjithatë nuk kishte ende një zgjidhje, ndërkohë që zgjatja e afatit dymujor ishte e paargumentuar për veprime hetimore konkrete. Për shkak se aktiviteti i kundërligjshëm në këtë çështje ishte zhvilluar për një periudhë të shkurtër, nuk kishte dinamikë hetimesh. Zgjatja e hetimeve e datës 15.4.2016 ishte e paargumentuar dhe i referohej kryerjes së veprimeve procedurale me të pandehurit, e megjithatë nuk ishte kryer asnjë veprim në këtë drejtim.

- Së dyti, subjekti ka konstatuar se prokurori, me fillimin e procedimit penal, e ka cilësuar faktin si vepër penale të trafikimit të narkotikëve, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, vepër penale e cila ishte në kompetencë të Prokurorisë për Krime të Rënda. Më pas, me ndërhyrjen e policisë në shtëpinë (vilën) ku është gjetur lënda narkotike dhe është bërë arrestimi në flagrancë i të dyshuarve, vepra penale e trafikimit të narkotikëve ka rënë, pasi tashmë ishte larg çdo elementi trafikimi.

Në këtë situatë, prokurori i çështjes i ka dhënë faktit cilësim tjetër juridik, duke i cilësuar faktet për veprën penale “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, e kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 333/a i Kodit Penal. Subjekti shpjegon se zgjidhja e bërë nga prokurori për të regjistruar veprën penale të kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal është bërë për të vazhduar kompetencën e Prokurorisë për Krime të Rënda për këtë çështje, pasi mungesa e kësaj vepre tashmë e nxirrte jashtë juridiksionit Gjykatën për Krime të Rënda (neni 751/a i Kodit të Procedurës Penale).

- Së treti, subjekti argumenton se aktiviteti i kundërligjshëm ishte zhvilluar në kuadrin e katër ditëve, nga data 12 deri në datën 16 tetor, datë në të cilën është ndërhyrë nga policia. Pavarësisht se sasia e lëndës narkotike ishte e madhe dhe numri i personave të përfshirë si autor të veprave penale plotësonte numrin minimal të grupit të strukturuar kriminal, ndërhyrja në kushtet e flagrancës kishte shkëputur çdo mundësi për hetime nëse kishte persona të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet, si dhe cili ishte destinacioni i lëndës narkotike.

Ndërhyrja e policisë ka shkëputur mundësinë e marrjes së të dhënave nëse kishim të bënim më një grup të strukturuar kriminal ose me trafikim të lëndës narkotike, e cila besohet se do të ndodhte. Aktiviteti në kuadrin e tri ditëve dhe numri i personave të marrë në përgjegjësi nuk ishte e mjaftueshme për ta cilësuar veprën penale të mbajtjes së narkotikëve, si të kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal.

Subjekti argumenton se vepra penale kryesore është cilësuar drejt nga prokurori i çështjes, por kjo veprë ishte kryer si rezultat i bashkëpunimit të thjeshtë dhe jo në formën e grupit të strukturuar kriminal, e cila e bënte kompetente Gjykatën për Krime të Rënda Tiranë, pranë të cilës ushtronte funksionet Prokuroria për Krime të Rënda.

Për rrjedhojë, bazuar në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka proceduar me vendimin për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si prokuroria kompetente e vendit ku ishte kryer vepra penale dhe kishte ardhur pasoja, aty ku ishte gjetur dhe sekuestruar lënda narkotike.

Drejtuesi i prokurorisë ka dhënë zgjidhjen përfundimtare në hetimin e këtij procedimi duke vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore dhe kalimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 31.5.2016.

Subjekti ka argumentuar se vendimi i tij për shpalljen e moskompetencës është mbështetur në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017⁸, të këtij kodi, ku parashikohej shprehimisht se prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e prokurorit më të ulët.

Gjithashtu, në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar në nenin 3/b), është përcaktuar shkalla e hierarkisë në prokurori. Në pikën 1 të këtij neni parashikohet se shkalla e hierarkisë në prokurori, sipas niveleve të organizimit dhe të funksionimit në drejtimin e centralizuar, nga prokurori më i lartë te prokurori më i ulët, është si vijon dhe në pikën 2 parashikohet se prokurorët, drejtuesit e drejtorive në prokurorinë e përgjithshme, drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, janë prokurorë më të lartë se prokurorët në strukturat përkatëse, ku ata ushtrojnë funksionet.

Po ashtu, në nenin 4 të këtij ligji “Ligjshmëria e veprimtarisë”, në pikën 1, parashikohet se prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve dhe në pikën 2 parashikohet se prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut.

Subjekti ka argumentuar gjithashtu se vendimi i tij për shpalljen e moskompetencës është i drejtë dhe i argumentuar duke shpjeguar se:

⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 24, “funksionet e prokurorit”, ku është parashikuar pavarësia e prokurorëve (ka ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) dhe ka hyrë në fuqi në datën 1.8.2017.

- Prokuroria që ka marrë aktet nuk e ka kundërshtuar këtë vendimmarrje, megjithëse kishte të drejtë, sipas parashikimeve të nenit 28/2 të Kodit të Procedurës Penale, të informonte Prokurorin e Përgjithshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.

- Po ashtu, nuk ka rezultuar se prokurori i çështjes të kishte një qëndrim tjetër nga vendimi i Drejtuesit të Prokurorisë, pasi kishte gjithë të drejtën për të ankuar këtë vendim te prokurori më i lartë, Prokurori i Përgjithshëm (neni 24/5 i Kodit të Procedurës Penale) dhe mosankimi prezumon se prokurori ishte dakord me vendimin e drejtuesit të prokurorisë.

- Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se zgjidhja e dhënë prej tij, për cilësimin juridik të faktit, është gjetur e drejtë edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimet respektivë me nr. (11-2017-2180)**, datë 4.5.2017 dhe nr. 10-2018-91/**, datë 23.1.2018. Ndërkohë, me vendimet e mësipërme, njëri nga të pandehurit është deklaruar i pafajshëm dhe një tjetër është dënuar për veprën penale të moskallëzimit të krimit.

Trupi gjykues ka konkluduar se vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 31.5.2016, i përpiluar nga drejtuesi i prokurorisë, z. Besim Hajdarmataj, është hartuar nga ana formale në përputhje me ligjin procedural penal, bazuar në nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohej shprehimisht se prokurori më i lartë ka të drejtë të ushtrojë kompetencat e prokurorit më të ulët.

Vlerësimet dhe konstatimet e paraqitura nga Komisioni i referohen hetimeve shteruese që duhet të ishin kryer për këtë çështje, të cilat i përkasin prokurorit të çështjes.

- Procedimi penal nr. ***/2012, i ngritur ndaj gjyqtarës T. H, në Gjykatën së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si e dyshuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, sipas nenit 248 të Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit është në detyrën e drejtuesit të prokurorisë.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2012 pas kallëzimit të shtetasit A. B.

Në datën 22.2.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar emrin e shtetasës T. H., (gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), si të dyshuar për veprën penale “shpërdorim detyre”, sipas nenit 248 të Kodit Penal.

Më 18.6.2013, Prokuroria e Rrethit Tiranë ka shpallur moskompetencën për shkak të kushteve të parashikuara në nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale dhe ka transferuar çështjen pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila më 10.7.2013 ka regjistruar çështjen dhe ka vijuar hetimin

Më 22.11.2013, subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, drejtues i prokurorisë, ka vendosur se: *“Nga analiza e akteve të këtij procedimi penal është konstatuar se autoriteti kompetent për vazhdimin e procedimit penal nuk ishte Prokuroria e Rrethit Durrës”*, duke nxjerrë një vendim ku deklarohet moskompetenca dhe transferimi i çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Elbasan.

Prokuroria e Përgjithshme⁹, në lidhje me këtë çështje, arsyeton se vlerësimi i prokurorit për shpalljen e moskompetencës është një e drejtë ligjore në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjit organik. Është prokurori ai i cili ka atributet gjatë hetimit paraprak për të vlerësuar konform ligjit procedural penal nëse është kompetent për ushtrimin e ndjekjes

⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 14.12.2018.

penale. Pikërisht në zbatim të të drejtës që i jep ligji, drejtuesi i prokurorisë, bazuar në nenin 28 dhe 84 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore, duke i kaluar aktet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo e fundit e ka pranuar kompetencën, duke e konsideruar të drejtë arsyetimin e subjektit të rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nëse nuk do të ishte dakord me vazhdimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale si prokuroria kompetente, në bazë të nenit 89 të Kodit të Procedurës Penale të kohës kishte të drejtë që të bënte konflikt kompetence, duke e paraqitur mosmarrëveshjen te prokurori më i lartë. Pretendimet për kompetencën janë ngritur nga kallëzuesit edhe në gjykatat që i ka trajtuar në vendimin e saj, dhe që në përfundim ka arritur në konkluzionin e lënies në fuqi të vendimit të pushimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Nga verifikimi i akteve nga Komisioni është konstatuar se:

Baza ligjore e përdorur nga prokurori në dispozitivin e vendimit nuk është në përputhje me arsyetimin, pasi në vend të nenit të aplikueshëm 78 është shkruar neni 76.

Subjekti i rivlerësimit, në arsyetimin e paraqitur¹⁰ për transferimin e çështjes, ka gabuar në interpretimin e nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale (*që parashikon përcaktimin e kompetencës vendore, që prek nocionin e “gjykatës së përcaktuar me ligj”, sipas nenit 42 të Kushtetutës*) për çështjet të cilat duhej të ishin vendosur duke iu referuar disiplinës së heqjes dorë/mosmarrjes pjesë në gjykim në bazë të neneve 15,16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale. Në fakt, është e qartë se neni 78 mund të zbatohet vetëm kur gjyqtari/prokurori merr cilësinë e të pandehurit ose të personit të dëmtuar nga vepra penale, ndërsa (në kundërshtim me këtë rast) prokurori e ka zbatuar këtë dispozitë në rastin e vëllait të një prokurori. Gjithashtu, ky i fundit as nuk ka qenë i regjistruar si i dyshuar në momentin e marrjes së vendimit, dhe as më pas. Evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në mospërputhje me kriteret ligjore (të bazuara në Kushtetutë) mbi atributet e gjykatës për të zgjidhur një situatë të thjeshtë të konfliktit të interesit të mundshëm që duhej të ishte adresuar me anën e mjeteve të tjera procedurale.

Arsyetimi për transferimin e çështjes është i dobët dhe nuk qartëson këndvështrimin se përse roli i shtetasit A. Sh., do përbënte bazë për transferimin e çështjes, duke cituar arsyet e mundësisë (*duke paragjykuar çështjen*), argumente që nuk qëndrojnë ligjërisht. Në çdo rast, është e qartë se prokurorit të cilit i është ngarkuar çështja ishte znj. E. B, e cila kishte kryer hetimin e çështjes dhe kishte planifikuar hapa të mëtejshme hetimore kur Drejtuesi i Prokurorisë ndërhyri, duke urdhëruar transferimin e çështjes në një qytet tjetër.

Në lidhje me arsyen e dytë të përmendur nga subjekti në vendim për transferimin e çështjes, se distanca e Tiranë - Elbasan është më e shkurtër se distanca Tiranë - Durrës, duket e paqartë ky argument i përdorur, sepse këtë fakt subjekti kishte mundësi që ta konstatonte që në momentin e regjistrimit të procedimit penal.

¹⁰ Arsyet e parashtruara në vendim për transferimin e çështjes janë: subjekti i rivlerësimit.

- a) Në tetor 2013, prokurori A. Sh është emëruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës si drejtor i Njësisë së Përbashkët Hetimore që trajton hetimin e çështjeve për veprat penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal. Në procedimin penal nr. ***2013 të regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, shtetasi që ka bërë kallëzim pretendon se gjyqtarja ka qenë e ndikuar në marrjen e vendimit nga vëllai i prokurorit A.SH, përkatësisht avokati A.Sh. Ky pretendim nga shtetasi që ka bërë kallëzim kundër vëllait të drejtorit të Njësisë Hetimore të Përbashkët – si strukturë e specializuar – do të bënte çdo vendimmarrje të marrë nga prokurori pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të paragjykuar.
- b) Pikërisht, në bazë të arsyeve të mësipërme por gjithashtu nga informacioni i disponueshëm se distanca Tiranë-Elbasan nëpërmjet autostradës së re është 27km, d.m.th., më e shkurtër se distanca Tiranë-Durrës nëpërmjet autostradës rreth 33 km, ne konsiderojmë se referimi i nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, prokuroria me kompetencë për hetimin e çështjes në fjalë është Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, pasi është prokuroria e rrethit më të afërt.

Subjekti ka depozituar prapësimet e tij, duke argumentuar se:

- Gjatë fazës së hetimeve, për shkak të kërkesave dhe memove të palëve, të cilat i drejtoheshin drejtuesit të prokurorisë, ka marrë për studim këtë procedim penal dhe për rrjedhojë ka arritur në një konkluzion se çështja në fjalë kishte diskutim në lidhje me kompetencën për të vijuar procedimin në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Për të konsoliduar praktikën që mund të lindi në vijim, për çështjet që lidheshin me nenin 78 të Kodit të Procedurës Penale, në rastin konkret, subjekti ka ushtruar kompetencat si prokuror më i lartë, në përputhje me parashikimet e nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Për sa i përket argumentimit të shpalljes së moskompetencës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kalimit të akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, janë marrë parasysh parashikimet e nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa baza ligjore e vendosur në vendimin e datës 22.11.2013 është një lapsus, pasi mund të jetë punuar mbi akte të mëparshme, ndërkohë që analiza e shkaqeve të transferimit i referohet parashikimeve të nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, si një dispozitë e veçantë për punonjësit e drejtësisë (gjyqtarë, prokurorë).

Subjekti ka sjellë të njëjtat argumente që ka përdorur mbi vendimet për shpalljen e moskompetencës.

- Subjekti ka argumentuar se shpallja e moskompetencës është bërë në një fazë kur nuk ishte konkluduar për mënyrën e përfundimit të hetimeve dhe, për rrjedhojë, kjo zgjidhje nuk ka ndërprerë ose penguar asnjë iniciativë të vendimmarrjes së prokurorit të çështjes. Vendimi i shpalljes së moskompetencës për vijimin e mëtejshëm të hetimeve për këtë çështje nuk e ka cenuar rezultatin e hetimeve, por as nuk ka ndërprerë ndonjë vendimmarrje të prokurorit të çështjes.

- Subjekti ka argumentuar se nëse prokurori i çështjes do të kishte një qëndrim tjetër nga vendimi i drejtuesit të prokurorisë, referuar nenit 24/5 të Kodit të Procedurës Penale, kishte të drejtën për të ankuar këtë vendim te Prokurori i Përgjithshëm. Mosankimi prezumon se prokurori ishte dakord me vendimin e drejtuesit të prokurorisë.

- Prokuroria e Rrethit Elbasanit, që ka marrë aktet, nuk e ka kundërshtuar këtë vendimmarrje, megjithëse kishte të drejtë, sipas parashikimeve të nenit 28/2 të Kodit të Procedurës Penale, të informonte Prokurorin e Përgjithshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.

- Nga studimi i akteve në dosje ka rezultuar se kallëzuesi, në kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes, ka ngritur pretendim edhe për kompetencën për të proceduar këtë procedim, por nga gjykatat e të tria shkallëve nuk është marrë parasysh ky pretendim, çfarë tregon se vendimmarrja e drejtuesit/subjektit të rivlerësimit është çmuar i drejtë nga gjykatat.

Në këtë çështje, konstatimet e Komisionit i referohen veprimeve të subjektit të rivlerësimit në rolin e drejtuesit të prokurorisë.

Trupi gjykues ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, vendimin për shpalljen e moskompetencës, e ka mbështetur në ligjin referuar të drejtës funksionale, si drejtues i prokurorisë për të ndërhyrë. Ai ka ushtruar kompetencat si prokuror më i lartë, në përputhje me parashikimet e nenit 25/2 të Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me faktin që pretendimet e ngritura nga denoncuesi janë gjykuar edhe nga gjykatat më të larta që kanë marrë në shqyrtim çështjen, trupi gjykues çmon se nuk ka kompetencë për të hyrë në themel të çështjes mbi atë që gjykatat më të larta kanë vendosur.

- Lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2010, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në ngarkim të shtetasit M. L., ka rezultuar se:

- Procedimi është regjistruar nga subjekti i rivlerësimit si drejtues i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me nr. *** më 7.5.2010, për veprën penale “kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik” dhe “vetëgjyqësia”, parashikuar nga nenet 235/1 dhe 277 të Kodit Penal.

Nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, datë 7.5.2010, deri në momentin kur është vendosur pushimi i hetimeve, në datën 27.7.2011, pas 1 viti, 2 muaj dhe 20 ditë, nga prokuroria nuk është kryer asnjë veprim tjetër procedural. Të vetmet veprime janë ato të kryera nga Komisariati i Policisë Kurbin në datat 4 dhe 5 maj të vitit 2010. Prokurori ka bërë vetëm vlerësimin e një sekuestroje të datës 4.5.2010. Në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, në dispozitivin e aktit, në pikën 3, për kryerjen e veprimeve hetimore është urdhëruar Oficeri i Shërbimeve të Policisë Gjyqësore që ka përpiluar informacionin për referimin e veprës penale. Nuk ka urdhër delegimi dhe asnjë veprim të kryer pas regjistrimit të procedimit penal.

Për këtë procedim, më 27.7.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të pushojë hetimin, referuar gërmës “a”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale, duke konkluduar se fakti nuk ekziston.

Nga verifikimi i akteve u konstatua se nuk janë kryer veprime hetimore nga Prokuroria e Rrethit Kurbin. Gabimet/mosveprimet nga subjekti janë të dukshme, për të cilat i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Në prapësimet e datës 4.10.2019, subjekti i rivlerësimit depozitoi në cilësinë e provës:

- analizën vjetore të punës për vitin 2010, për të mbështetur argumentimin se ka pasur ngarkesë në punën e tij si drejtues dhe si prokuror;
- grafikun e gatishmërisë me nr. ***, datë 30.4.2010, sipas të cilës rezultoi se subjekti në datën e regjistrimit të procedimit penal të shtetasit M. L., ka qenë prokuror i gatshëm sipas grafikut.

Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se:

Ky procedim penal i ka rënë për shkak të grafikut të gatishmërisë. Referuar grafikut të gatishmërisë, depozituar në cilësinë e provës, rezultoi se subjekti në datën e regjistrimit të procedimit penal 7.5.2010, ka qenë prokuror i gatshëm.

Gjetjet e Komisionit për të kryer veprime shteruese hetimore, subjekti i ka konsideruar të drejta, sepse ezauroheshin shumë pretendime, por subjekti ka argumentuar se këto veprime hetimore nuk do të ndikonin në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Lidhur me zvarritjen e vendimmarrjes, subjekti ka argumentuar se gjatë atij viti ka mbuluar një punë të konsiderueshme si prokuror, duke hetuar dhe përfaqësuar në gjykim një numër të konsiderueshëm procedimesh penale, për vepra penale të rënda dhe shumë sensitive për rrethin gjyqësor në fjalë. Vepra penale të rënda dhe sensitive janë parë me përparësi dhe duke u përfshirë në dinamikën e punës kanë ardhur për rrjedhojë edhe vonesa në vendimmarrje për ndonjë procedim tjetër, siç ishte dhe procedimi penal nr. ***/2010. Subjekti ka theksuar se përgjatë atij viti kishte mungesë organike të prokurorëve, ndërsa numër të shtuar të çështjeve, të cilat kanë ndikuar në zvarritjen e hetimeve për ndonjë çështje të caktuar.

Për sa i përket analizës së fakteve, subjekti argumenton se mungesa e faktit të veprave penale të parashikuara nga nenet 235 dhe 277 të Kodit Penal, evidentohet në disa konstatime. Në fakt, në atë periudhë kishte përhapje të gjerë të veprës penale të lojërave të fatit dhe kishte qendra

lojërash fati kudo, ndaj është shumë e dyshimtë fakti që punonjës të NJMLF-së të udhëtonin deri në qytetin e Dibrës për të sekuestruar pesë makina kompjuterike. Në aktin e konfiskimit nr. ***, mbajtur në datën 4.5.2010, e cila gjendet në fashikullin e çështjes, citohet: *“U konstatua se ushtronte aktivitet lojëra fati, i papajisur me dokumentet e duhura”* dhe, pasi përmend numrat e serive të makinave kompjuterike, në vijim citohet: *“U bë konfiskimi i tyre dhe u dërguan pranë magazinave të NJMLF-së”*, çfarë nënkupton se tashmë makinat kompjuterike ishin magazinuar. Punonjësit e NJMLF-së nuk kishin asnjë plan pune për udhëtimin me shërbim në drejtim të qytetit të Dibrës, i cili do të dokumentonte udhëtimin e këtyre punonjësve për kontroll të aktivitetit të lojërave të fatit. Një dokument i tillë pasqyrore dhe ligjëronte faktin se këta punonjës ishin në kryerjen e një detyre shtetërore, ose në shërbim publik. Urdhërshërbimi që mban datën *.*.2010 është pa numër protokolli dhe nuk sqaron asgjë në lidhje me udhëtimin në shërbim të këtyre punonjësve për në qytetin e Dibrës, ose me objekt të caktuar. Mungesa e këtyre dokumenteve ka vënë në dyshim faktin se këta punonjës ishin duke kryer një detyrë shtetërore ose në shërbim publik, si një nga elementet kryesor të veprës penale. Vënia në dispozicion e aktit të sekuestrimit dhe urdhrin të shërbimit nga punonjësit e NJMLF-së, Oficerit të Policisë Gjyqësore, është bërë me shumë vonesë në orën 23:30, datë 4.5.2010, ndonëse ngjarja kishte ndodhur rreth orës 17:30, çfarë tregon se këto akte nuk ishin përpiluar në vend.

Subjekti ka shtuar gjithashtu se një fakt tjetër i rëndësishëm është mungesa e njoftimit të faktit nga punonjësit e NJMLF-së në policinë vendore Dibër, për të filluar ndjekjen penale për veprën penale “organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, ndaj personit që ushtronte këtë aktivitet. Nëse ngjarja e marrjes me forcë e makinave kompjuterike ka ndodhur në të vërtetë, ndërkohë që ngjarja ishte duke ndodhur, kallëzuesi dhe secili nga punonjësit e NJMLF-së kishte mundësi të njoftonte edhe me telefon policinë vendore. Me marrjen e këtij informacioni policia mund të merrte masa për kapjen në flagrancë të personave të kallëzuar, kontrollin e tyre etj. Marrja e kompjuterëve, siç përshkruhet nga kallëzuesi dhe punonjësit e NJMLF-së, pa asnjë lloj rezistence të tyre, e bënte këtë fakt të dyshimtë.

Trupi gjykues ka konkluduar se mangësitë e evidentuara në hetim dhe zvarritja të procesit hetimor janë të drejta. Në gjykim të rrethanave dhe fakteve, prokurori i çështjes nuk ka kryer të gjithë veprimet e nevojshme hetimore, të cilat do të ligjëronin vendimmarrjen e tij në prova dhe fakte konkrete se përse veprimi nuk përbënte vepër penale. Argumentimi i subjektit është i dobët sepse ka shumë elemente dhe veprime hetimore të cilat duhet të ishin kryer.

Konkluzione lidhur me katër dosjet penale të analizuar nga Komisioni

Në vlerësim të shkeljeve të konstatuara në dosjet e sipërtrajtuara për të cilat subjektit iu kalua barra e provës në rezultatet shtesë të hetimit, që i përkasin procedimeve penale nr. ***/2013; nr. ***/2017; nr. ***/2015; nr. ***/2012, subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, ka ushtruar funksionet si drejtues i prokurorisë.

Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë se vlerësimi i aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit bazohet në cilësinë e prokurorit apo gjyqtarit dhe në respektim të dispozitave ligjore, si më poshtë vijon:

- Pika 1 dhe 2, e nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, përcakton: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit.”*

- Vlerësimi i aftësisë për prokurorët përfshin aftësinë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj.
- Arsytimi ligjor dhe rivlerësimi profesional, sipas dispozitave të pikës 1, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”*.
- Në respektim të dispozitave ligjore të parashikuara në nenin 43, të ligjit nr. 84/2016, *“Procedura për vlerësimin e aftësisë profesionale”*, sipas të cilës *“procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm”*.
- Pika 2, e nenit 73, e ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* përcakton: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.*
- Pika 4, e nenit 73, e ligjit nr. 96/2016, përcakton: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”*.
- Dispozitat ligjore të sipërcituara duhen trajtuar të lidhura me ato të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i cili në nenet 180 e vijues të tij përcakton funksionet e KLP-së.
- Neni 59, i ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *“Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”*.
- Vendimi nr. 2/2017, i Gjykatës Kushtetuese, në paragrafin 54 parashikon: *“...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ.”*
- Në paragrafin 52 të këtij vendimi, parashikohet se: *“Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”* (sipas opinionit CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).
- Pika 6, e nenin 171, e ligjit nr. 96/2016, rregullon regjimin tranzitor, ku parashikohet se: *“Vlerësimi etik dhe profesional i kryetarit, në cilësinë e këtij funksioni, do të realizohet në mënyrë të pavarur nga procesi i rivlerësimit dhe do të kryhet paralelisht nga KLGJ dhe KLP, sipas një programi që miratohet prej tyre”*.

Përfundimisht u konkludua

Në vlerësim tërësor për këto katër çështje penale të analizuara nuk rezultuan të dhëna/prova që të provonin se veprimet e drejtuesit ishin të paramenduara; nuk janë të mjaftueshme për ta vlerësuar me mangësi profesionale; nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij; nuk janë të mjaftueshme për t'i çmuar si sjellje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e këtij prokurori, dhe si të tilla, për këto çështje ku subjekti është me cilësinë e funksionit të drejtuesit, nuk mund të konsiderohet i papërshtatshëm si subjekt rivlerësimi në cilësinë e prokurorit.

Trupi gjykues çmon se edhe çdo interpretim ndryshe që mund t'i bëhet mos përmbushjes së rolit si drejtues, duhet të vlerësohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organ i ngarkuar me ligjin nr. 96/2016.

Një vlerësim ndryshe do të ishte në kundërshtim me parashikimet e pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se vlerësimi i aftësive profesionale për prokurorët përfshin aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj.

Në lidhje me procedimin penal nr. * të vitit 2010**

Trajtuar më sipër, ku subjekti ka vepruar në cilësinë e prokurorit të çështjes, trupi gjykues, për shkak të mangësive të konstatuara në dosjen penale, ka vlerësuar se këto mangësi mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, gjykon se kjo dosje duhet t'i transferohet organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Me cilësinë e relatores së çështjes, në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional, pas shqyrtimit të Raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe pas hetimit të pavarur të Komisionit, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme. Nuk u provua asnjë indice apo element që të cenonte figurën e prokurorit, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit propozoj: “i aftë”.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besim Hajdarmataj, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë.
2. Transferimin e çështjes me nr. 129 akti, të vitit 2010, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.10.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha